



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.10.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 18.09.2018 dhe 19.09.2018.
2. Miratimi i kalendarit trejavor të punimeve të komisionit.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, aderuar me ligjin nr.8850/2001, dhe protokollin 2005 të Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, aderuar me ligjin nr.8850/2001”.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European për programin e veprimt të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri – Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Andrea Marto, Ervin Bushati, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Eglantina Gjermani, Xhemal Qefalia, Ilir Xhakolli dhe Bashkim Fino.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshaj, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari dhe Edmond Panariti.

Të ftuar:

Rovena Voda – Zëvendësministre e Brendshme

Elona Hoxhaj –Drejtoreshë Juridike e Ministrisë së Brendshme

Alma Jemini – Shefe Sektori në Drejtorinë Juridike në Ministrinë e Brendshme

Gazmend Barbullushi – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët
me Jashtë

Danjela Çekani – Drejtoreshë e Fondeve IPA në Ministrinë për Europën dhe Punët
me Jashtë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Politikën e Jashtme.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 18 dhe 19 shtator, miratimin e kalendarit trejavor të punimeve të komisionit, si dhe shqyrtimin e dy projektligjeve, atë “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, aderuar me ligjin nr.8850/2001, dhe protokollin 2005 të Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, aderuar me ligjin nr.8850/2001”. Për të diskutuar rreth këtij projektligji kemi të ftuara nga Ministria e Brendshme: zonjën Rovenë Voda, zëvendësministre; zonjën Hoxhaj, drejtoreshë Juridike, si dhe zonjën Jemini, shefe sektori në Drejtorinë Juridike.

Mirë se vini në komision!

Projektligji i dytë në rend dite është ai “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri – Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”. Të ftuar për këtë projektligj kemi zotin Barbullushi, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët me Jashtë, dhe zonjën Çekani, drejtore e Fondeve IPA, po nga kjo ministri.

Zonja Voda, ju lutem, dy fjalë lidhur me projektligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kërkoj ndjesë! Fillimisht kemi miratimin e procesverbaleve të datave 18 dhe 19 shtator. Ka ndonjë kundërshtim? Nuk ka.

Miratohe të dyja procesverbalet.

Gjithashtu, kemi miratimin e kalendarit trejavor të punimeve të komisionit. Keni ndonjë propozim, ndonjë kundërshtim?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

E konsiderojmë të miratuar.

Faleminderit!

Zonja Voda, fjala është për ju.

Rovena Voda – Faleminderit, zonja kryetare e komisionit!

Protokollet e konventave që vijnë sot para jush janë iniciuar në kuadër të legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar lidhur me mbarëvajtjen e paqes, sigurisë së

lundrimit ndërkombëtar, duke promovuar siguri, marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunim ndërmjet shteteve anëtare. Mjafton të përmend se konventa bazë e këtyre dy protokolleve është ratifikuar që në vitin 2001 dhe, sigurisht, ndërkohë vijmë me aderimin në këto dy protokolle shtesë.

Aderimi në këto organizma synon të forcojë bashkëpunimin dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Ndërkombëtare Detare për të rritur efikasitetin në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit në aspektin e sigurisë detare, duke bashkëpunuar me organet kompetente.

Aderimi, e theksoj sërish, i Republikës së Shqipërisë në këto protokolle të konventave kryhet në kuadër të përmbushjes së prioriteteve të qeverisë shqiptare në luftën kundër krimit në tërësi, goditjes së trafikimit dhe akteve terroriste, të cilat synohen të realizohen në rrugë detare.

Duke pranuar se akte të tilla të kundërligjshme kërcënojnë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, pikërisht kjo është edhe arsyeja e aderimit në këto konventa.

Vlen të theksohet se aderimi në protokollat e këtyre dy konventave është iniciuar nën frymën e respektimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në pajtim me legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë. Kuadri ligjor i brendshëm bazohet kryesisht në ligjin “Për Policinë e Shtetit” dhe në ligjin “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, dua t’ju them se miratimi i këtij projektakti ka qenë i parashikuar në programin analitik të projekteve për vitin 2018 të Ministrisë së Brendshme.

Në thelb, Republika e Shqipërisë, nëpërmjet aderimit në këto konventa, bën të mundur realizimin e një hapi përpara drejt konsolidimit të kuadrit ligjor detar. Këto protokolle kërkohet të ratifikohen për t’u bërë pjesë e legjislacionit, më pas të legjislacionit të brendshëm. Sigurisht, nëpërmjet aderimit në këto konventa, vendi ynë merr përsipër të drejta dhe detyrime, që lindin nga kuadri ligjor ndërkombëtar.

Risi në këto protokolle është parashikimi i një sërë veprash penale, po themi, shtesë, që ndodhin në territorin detar dhe që, sigurisht, më pas do të lindë si domosdoshmëri që këto të jenë pjesë edhe e legjislacionit tonë të brendshëm.

Besoj se më me interes, dhe që do ta veçoja, është pjesa e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Ndërkombëtare Detare apo shteteve palë në raste të caktuara. Sigurisht, detajet e shkëmbimit të informacionit më pas do të jenë më të detajuara në marrëveshjet dypalëshe apo në protokollat konkrete të bashkëpunimit. Unë mendoj se është një vlerë e shtuar, meqenëse zgjerohet gama e veprave

penale që parashikojnë këto protokolle. Siç ju thashë, vlerë të shtuar merr shkëmbimi i informacionit. Ndoshta, tashmë është fjalë kyçe shkëmbimi i informacionit në fushën e sigurisë në bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar të Shqipërisë me vendet e tjera. Besoj se lidhet patjetër, siç e thashë edhe në fillim, me prioritetet e Ministrisë së Brendshme, por edhe të qeverisë shqiptare për të rritur sigurinë kombëtare.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Ka pyetje?

Më lejoni mua t'ju bëj një pyetje. Kur ju flisni për aderimin në këtë protokoll dhe respektimin e konventës së ndalimit të akteve të paligjshme në fushën e lundrimit detar, e keni fjalën për atë pjesë apo atë fashë nga bregdeti deri aty, ku mbulon Ministria e Brendshme apo deri aty, ku Ministria e Mbrojtjes mbulon, e keni fjalën për ujërat ndërkombëtare apo për të gjitha këto bashkë?

Folët për shkëmbime informacioni. Unë besoj se e drejta ndërkombëtare e lundrimit hyn në fuqi në qoftë se një mjet lundrues ndodhet në njërën nga këto fasha që përmenda. Në qoftë se mjeti lundrues ndodhet apo fakti, event i apo ndodhia ndodhet në një fashë tjetër, hyn një e drejtë tjetër, që mund të jetë e brendshme, mund të jetë ndërkombëtare, mund të jetë e pafiksuar akoma në legjislacionin shqiptar.

Rovena Voda – Për sa u përket kufijve, megjithëse besoj se pyetja juaj është tjetër, por akti bazë, apo ligji i detit, që njohim ne, është Konventa e Montego Bay-t, që futet edhe në përcaktimet e shelfit kontinental etj.

Unë besoj se qëllimi i kësaj konvente lidhet më shumë me pjesën e sigurisë. Pra, me pjesën e veprave penale të ndodhura në territorin e detar të Republikës së Shqipërisë. Besoj se konventa ka disa përcaktime, disa përkufizime në të cilat shpjegohet se çfarë është platforma fikse, rastet kur do të kemi akte apo vepra penale kundër sigurisë së platformave fikse. Besoj se në këtë përkufizim dhe në këtë hapësirë, që lejojnë këto protokolle shtesë, do të shtrihet edhe juridiksioni ynë, i Policisë së Shtetit, i policisë shqiptare për të vepruar.

Mimi Kodheli – Zonja zëvendësministre,

Juridiksioni juaj në det është i mirëpërcaktuar. Juridiksioni i Ministrisë së Mbrojtjes në det, është i mirëpërcaktuar. Këto janë dy juridiksione të ndryshme. Jo vetëm kaq, por flitet për dy fasha të ndryshme ujore. Me këtë aderim, sepse duhet të kishte edhe përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes në këtë rast. Ju thoni se shkëmbeni informacion. Ju shkëmbeni informacion deri në një fashë detare. Nga ajo fashë deri në një fashë tjetër detare, duhet që

informacioni të përpunohet edhe nga një strukturë tjetër. Nuk e di a jam e qartë, sepse në Republikën e Shqipërisë, që është një vend i NATO-s, *coast guard*-in nuk e bën policia, por e bën ushtria. Pra, si lidhen këto dy institucione të rëndësishme të Republikës së Shqipërisë (Ministritë së Mbrojtjes dhe Ministritë së Brendshme) me aderimin në këtë konventë?

Ju folët për siguri dhe për shkëmbime informacioni. Sa hyn kjo strukturë tjetër? Mos duhet të kishim edhe përfaqësues të Ministritë së Mbrojtjes, të cilët duhet të jenë të njohur me aderimin në këtë konventë dhe duhet të kenë pjesën e tyre të shkëmbimit të informacionit apo të respektimit të kësaj konvente për shkak të aderimit dhe të miratimit, që do të bëjmë sot.

Rovena Voda – Zonja kryetare e komisionit,

Në relacionin që shoqëron këtë projektakt është shkruar që me implementimin e saj do të merret Qendra Ndëroperacionale Detare (QNOD).

Ndoshta, edhe vërejtja juaj është e drejtë, se QNOD është një lloj institucioni mbledh në vetvete disa institucione bashkë, pra kemi Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Brendshme etj. QNOD-ja merr rolin e implementuesit dhe besoj se vërejtja juaj është e drejtë. Në fakt, unë po flisja si zëvendësministre e Brendshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vërejtje e rimarrë në kuptimin jo të drejtë të saj, por në kuptimin e sjelljes në vëmendje.

Ndërkohë, akti është konsultuar edhe me Ministrinë e Mbrojtjes, pra, e ka kaluar konsultimin e brendshëm dhe ministri i Mbrojtjes është shprehur parimisht dakord. Duke u nisur edhe nga ajo çfarë thatë ju, që roja bregdetare është në varësi, besoj se kjo gjë është zgjidhur duke vënë si implementues të këtyre dy protokolleve QNOD-në.

Mimi Kodheli – Tani jam më se e qartë.

Që kur ju përmendni QNOD-në, unë e kuptoj se për çfarë po flitet.

Nëse nuk ka pyetje të tjera, mendoj që ta kalojmë në votim.

Kush është dakord me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Faleminderit, zonja të nderuara! Punë të mbarë!

(Diskutim pa mikrofon)

Vërejtja e kolegut Fino është me vend

(Diskutim pa mikrofon)

Zoti Fino, të lutem, mos u provoko nga zoti Shameti.

Fjalën e ka zoti Barbullushi.

Gazmend Barbullushi – Zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Bashkë me zonjën Çekani kemi nderin të prezantojmë sot projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”.

Ratifikimi i marrëveshjes financiare krijon kushtet për zbatimin e përbashkët të projekteve në të ardhmen mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Projektligji për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje është propozuar nga Këshilli i Ministrave përmes vendimit nr. 536 të vitit 2018. Marrëveshja e financimit është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 249 të vitit 2017. Është nënshkruar nga pala jonë në korrik të vitit 2017 dhe finalizuar nga pala kosovare në muajin nëntor të vitit 2017.

Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë 2014-2020, është miratuar nga komisioni me vendimin zbatues të datës 11 dhjetor 2014. Alokimet e vitit 2016 për këtë program financohen nga një grant i BE-së nëpërmjet Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA me një buxhet total, për të dyja vendet, prej 1 411 765 euro. Bashkëfinancimi kombëtar i vendeve mund të shkojë në vlerën 180 000 euro, kurse kontributi i BE-së mbetet në nivelin 1 200 000 euro.

Zona e programit ku do të zbatohen projektet mbulon një territor prej afro 8400 kilometra katrorë, me një popullatë rreth 940 000 banorë.

Zonat përfituese në Shqipëri përfshijnë rajonet dhe qarqet e Kukësit dhe Lezhës, tetë bashki me një total prej 362 vendbanimesh, kurse në Kosovë përfshin Rajonin Ekonomik Perëndimor dhe Rajonin Ekonomik Jugor, me 12 bashki.

Programi i bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë mbështet shkëmbimin e eksperiencës, njohurive dhe përmirësimin e politikave publike mes autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale, si dhe aktorëve të tjerë të rajoneve të lejueshme në zonën e programit. Ka si qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të zonave, si dhe të forcojë më tej bashkëpunimin e natyrshëm midis shteteve duke marrë në konsideratë problematikën në terren, programi do të fokusohet në prioritetet e mëtejshme tematike.

Së pari, në mbrojtje të mjedisit, përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimaterike; parandalimin e menaxhimit të riskut.

Së dyti, në turizëm, trashëgimi natyrore dhe kulturore.

Së treti, për rininë, arsimin, me fokus nxitjen e punësimit.

Zonja kryetare, ky ishte një prezantim i shkurtër dhe bashkë me zonjën Çekani jemi të hapur për pyetje dhe komente.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Mimi Kodheli – Ju faleminderit, zoti Barbullushi!

A ka pyetje?

Po, zonja Gjermani, më pas zoti Fino. Në fund do të bëj unë tri pyetje.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetare!

Ju falënderoj për prezantimin!

E vlerësoj shumë këtë marrëveshje, sidomos për faktin që është midis Shqipërisë dhe Kosovës. Edhe ndihmë e Bashkimit Europian për të nxitur bashkëpunimin ekonomik dhe social të të dyja vendeve tona dhe është shumë e rëndësishme, sidomos për procesin e integritetit europian të tyre. Duke qenë se në përgjithësi nga projektet IPA apo nga projektet që vijnë nga Komisioni Europian vendet në zhvillim e kanë problem përthithjen e fondeve të tyre, dua të di, meqenëse ju jeni Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme dhe keni rolin koordinues për këto fonde, çfarë do të bëni për të nxitur hartimin e projekteve cilësore? Nuk mendoj se keni thjesht rol koordinues për zbatimin e tyre, por të informoni ose të ndërgjegjësoni të gjitha subjektet e interesuara, pushtetin vendor, shoqërinë civile, universitetet, së pari, për të aplikuar për të bërë projekte cilësore, më pas për t'i zbatuar që të mundësojnë marrjen e të gjitha këtyre fondeve dhe zhvillimin e zonave, të cilat përfaqësojnë

këto institucione që do të aplikojnë për fonde, duke u nisur edhe nga përvoja juaj e mëparshme?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetare!

Në fakt, sapo e diskutuam këtë projektligj në Komisionin e Ligjeve. Për fat të keq, unë nuk votova kundër thelbit të projektligjit, sepse projektligji është shumë i rëndësishëm dhe duhet ta kalojë, por për informacionin jo të bollshëm dhe të nevojshëm të relacionit që shoqëron këtë projektligj. Nuk do të përsërit pyetjen që bëra të Komisioni i Ligjeve, sepse nuk mora ndonjë përgjigje, ose të paktën unë nuk u kënaqa me përgjigjet. Gjithsesi, pak rëndësi ka si u përgjigjën. Ne vijmë sot të ratifikojmë një marrëveshje. E thashë në Komisionin e Ligjeve që në Shqipëri dy bashki fitojnë, Kukësi dhe Lezha, tetë nga Kosova, pra më shumë. Bravo u qoftë, sepse kanë projektet dhe programet më thelbësore dhe më serioze, kurse ne përfitojmë kaq pak! Përgatitja e dokumentacionit ka filluar nga viti 2013 deri më vitin 2014. Sot në vitin 2018 ne e ratifikojmë. Pra, u shpjegova zotërinjve këtu edhe raportin e vlerësimit të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit që këta nuk janë në gjendje ta thonë për vitin 2016, ndërkohë që sot jemi në vitin 2018. Pyetja ime është shumë e thjeshtë: meqenëse ju keni një rol koordinues, drejtues, atëherë sa projekte të IPA-s janë implementuar në Shqipëri dhe sa të tjera do të implementohen, ose sa janë fituar nga ne? Ky relacion që kam, për të cilin votova kundër atje, duhet të mirinformojë deputetët.

Nga kryetari i komisioni m'u tha, mbase me të drejtë, se ne nuk jemi komision përgjegjës, por komision për dhënie mendimi. Kjo nuk do të thotë që ne të mos bëjmë pyetje. Meqenëse ju jeni komision përgjegjës (dhe përfitoj sot që jam zëvendësues, sepse mungojnë disa nga kolegët e mi) pyetja imë është thelbësore: sa projekte kemi përfitur nga ky projekt i IPA-s dhe sa do të vazhdojë, që ne si deputetë të dimë nëse janë fituar, apo jo? Ne kemi edhe një mundësi tjetër, të cilën nuk e shfrytëzojmë siç duhet, as ju si kryetare e komisionit, por as ne, të drejtën e kontrollit të ekzekutivit, të drejtën e kontrollit të asaj që ne votojmë në parlament. Unë votoj një projektligj, një grant, një kredi, që është e fëmijëve të mi, e fëmijëve të tu, e fëmijëve të këtyre dhe fëmijët e shqiptarëve, që ju ngelet në kurriz. Kjo do të thotë se unë duhet ta kontrolloj si ligjvënës dhe në momentin që duhet ta kontrolloj, sot në vitin 2018, a mund të më thuhet se çfarë kam përfitur unë, Shqipëria dhe Ministria e Jashtme, që është koordinatore nga programi IPA? Kjo nuk del në informacion që kemi këtu dhe, me mirëkuptimin tuaj, dua që të sillni një informacion më të detajuar për projektligjin, i cili të na

qartësojë edhe ne, në mënyrë që ta votojmë me kënaqësi në parlament. Pra, në thelb, nuk jam kundër projektligjit, por jam për një informacion të detajuar, që ne duhet të dimë. Këtu nuk vihet thjesht duke thënë: “Unë dua të kaloj këtë fond, kam këtë projekt, por të shohim kur do t’i bëjnë OJF-të dhe institucionet shtetërore, prandaj ju ngrini dorën se duhet ta kalojmë në parlament”, ne ta kalojmë dhe këta të livadhisin si të duan. Jo, këtu vihet me një program konkret se çfarë është bërë, sa do të bëhet dhe ne ta votojmë. Investimet dhe buxheti duhet të vijjnë të detajuar.

Mimi Kodheli – Fjala për ju.

Daniela Cekani – Faleminderit për pyetjet!

Po vijoj me përgjigjen ndaj zonjës Gjermani.

Që në momentin e hartimit të programit përkatës, për të cilin jemi mbledhur sot, Shqipëri-Kosovë, jo vetëm autoritetet shqiptare, por edhe ato kosovare dhe të gjitha palët e interesuara kanë kontribuar në hartimin e programit, pasi ministria në këtë rast është në rolin e koordinatorës për programet e bashkëpunimit territorial, një ndër të cilët është edhe programi Shqipëri-Kosovë. Pra, jo vetëm është hartuar bashkërisht me institucionet shtetërore, por është konsultuar edhe me palët e interesuara, duke përfshirë shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesit, që janë akademikët, universitetet, dhomat e tregtisë dhe të gjithë të tjerët të interesuar. Pra, në momentin që të gjitha strukturat kanë qenë së bashku, kanë vendosur për prioritetet që ky program do të mbështesë, bazuar edhe në zonat që konsiderohen zona të ligjshme të programit. Në këtë rast, duke iu përgjigjur njëkohësisht edhe pyetjes së zotit Fino, nuk kemi të bëjmë me një numër më të shumtë zonash në Kosovë dhe më pak në Shqipëri, por thjesht u referohemi bashkive ose në rang qarku. Përgjithësisht në këtë program territori është në nivele të barabarta për sa i përket numrit të popullsisë.

Aktualisht, ne jemi në momentin e miratimit të alokimeve vjetore 2016, për faktin se miratimi bëhet mbi baza vjetore dhe kjo vjen si rezultat i rregullores IPA. Pavarësisht se programet shtrihen në një perspektivë financiare 2014-2020, miratimi bëhet çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave dhe më pas ratifikohet në parlament.

Bashkimi European ndjekë një rregull, që konsiderohet si rregulli N+3. Pra alokimet vjetore 2016 kontrahohen dhe fillojnë të zbatohen implementimin në vitin 2019. Aktualisht ne jemi në një moment kur nuk është lancuar thirrja e dytë për projektpropozime, sepse ajo e para ka filluar zbatimin me alokimet e viteve 2014 dhe 2015. Aktualisht miratohen alokimet vjetore 2016, më pas hapet gara për projektpropozime, ndërtohen partneritete me pjesëmarrje të palëve të interesuara mes dy vendeve, ku rregulli është minimumi 1 partner nga pala

shqiptare dhe pala kosovare, jo domosdoshmërisht këta partnerë janë institucione qendrore, por mes tyre ka organizata jofitimprurëse, dhoma e tregtisë, të cilat nuk janë domosdoshmëri institucione buxhetore dhe vlerësimi i të ardhurave buxhetore bëhet i vështirë pikërisht për këtë fakt, që ende nuk kemi rezultate për projektet fituese, të cilat i nënshtrohen një procedure transparente, por që në këtë program autoritet kontraktor është delegacioni i Bashkimit European në Tiranë, i cili e bën këtë proces përzgjedhjeje projekti mbi bazën e rekrutimit të vlerësuesve të jashtëm mbi kritere të mirëpërcaktuara.

Duke qenë se këto projekte nuk kanë filluar zbatimin, ne, si shtet shqiptar, kemi detyrimin të bashkëkontribuojmë për mirëimplementimin dhe menaxhimin e programit në masën 15%, por në momentin kur ende nuk kemi projekte fituese dhe nuk kemi përcaktim të qartë të institucioneve qendrore, të cilat do të kontribuojnë në mirëmenaxhimin e këtij programi, nuk e dimë se sa do të jetë vlera dhe kjo është arsyeja pse pritet të zbardhet lista me projektet fituese. Pas përfundimit të këtij procesi të vlerësohet cili është kontributi për secilin partner dhe në rastin e partnerëve buxhetorë të vlerësohet sa duhet të jetë nën nivelin 15% kontributi përkatës, i cili planifikohet në buxhetin e çdo ministrie për çdo vit.

Bashkim Fino – Po bëj një pyetje idiote, jo në kuptimin e keq të fjalës. Po lexoj titullin e projektligjit, çfarë thotë titulli i projektligjit? Propozimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimtimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri-Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”, ashtu siç thatë edhe ju që ka një projekt. Pra, unë sot si parlamentar votoj në parlamentin shqiptar alokimet e vitit 2016.

Zonja kryetare, pyetja ime është: a do të vijë ky projektligj për alokimet e vitit 2017, për alokimet e vitit 2018, për alokimet e vitit 2019, për alokimet e vitit 2020, që mbaron projekti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Them se do të vijë. Atëherë, në qoftë se do të vijë, duhet të vijë i detajuar, sepse sot jemi në vitin 2018. Pyetja që bëra dhe që e kanë edhe deputetët e tjerë është: dua të di alokimet e fondeve të vitit 2016, sepse atë do të votojmë ne, ku janë, ku shkuan dhe çfarë është bërë për vitin 2016 në tetor të vitit 2018? Kurse ti më thua që nuk ke shpenzimet listën e të tjera. Shumë shpejt, për 3-4 muaj, do të votoj alokimet e vitit 2017, mund të ma sjellësh më shpejt, sepse këtë projektvendim e ke vonuar. Edhe atje e dua listën se çfarë do të alokohet për vitin 2017.

Zonja kryetare, sot nuk e kam këtë. Çfarë do të votojmë ne deputetët që ta kuptojnë të gjithë, sepse ju jeni komisioni përgjegjës? Ne votojmë alokimet e vitit 2016 të një projekti 2014-2020. As atëherë nuk mora përgjigje dhe nuk po marr përgjigjeni as tani. E dini pse e bëj këtë pyetje?! Sepse këtu shikoj se ju quheni Daniela Çekani, drejtoreshë e fondeve IPA, pra jeni vetëm për këtë çështje. Në Ministrinë e Jashtme shikoj se ju jeni drejtoreshë e fondeve IPA. Të jesh drejtoreshë për këtë fond dhe të mos dish se cilat janë alokimet dhe investimet e vitit 2016! Madje ju duhet të dini edhe alokimet e vitit 2017 apo të vitit 2018 e kështu me radhë. Këtë dua të vitit 2016, që të ngre dorën dhe ta votoj këtë alokim. Cila është lista e investimeve? Këtë nuk e kam këtu, në qoftë se ju e shikoni, ma thoni, prandaj e kam pyetje idiote, që ta kuptoj dhe t'ju kërkoj ndjesë.

Mimi Kodheli – Mendoj se, edhe në ndihmë të përgjigjes, që kolegu Fino kërkon dhe të insistimit të tij të drejtë lidhur me marrjen e informacionit nga ana e deputetëve dhe nga ana e komisionit, megjithëse Komisioni i Jashtëm nuk është një komision përgjegjës, sepse është Komisioni i Ekonomisë dhe Financave komision përgjegjës, por kjo nuk e bën aspak më përgjegjës komisionin tonë, shqetësimit të kolegut Fino, unë i bashkoj edhe një shqetësim timin lidhur me mënyrën se si ju informoni parlamentin shqiptar dhe komisionet respektive. Në gjykimin tim, ju nuk mund të vini dhe të kërkonit një kalim të marrëveshjes për alokimin e fondeve të vitit 2016, me pretendimin e drejtë nga ana juaj që fondet e vitit 2016 duhet të shikohen nga donatori, dhe kur Komisioni European të vendosë lidhur me fituesit e projekteve, ne të vendosim jo vetëm në parim siç do të bëjmë sot, por edhe më tutje, se çfarë është 15% e fondeve të alokuara të fituara tashmë si projekte, pas fazës së dytë të kalimit të së drejtës për të financuar projekte, sepse është bërë faza e parë, e thënë me dy fjalë, jemi në fazën e dytë apo jo, pra janë përcaktuar pjesëmarrësit, vjen faza e dytë do të përcaktohen fituesit, apo jo, të vitit 2016...

Daniela Çekani - Më lejoni të saktësoj: për alokimet e vitit 2016 nuk ka nisur ende asgjë. Paraprakisht miratohen alokimet, më pas shpallet thirrja për projektpropozime, e cila fton të gjitha aplikantët në funksion të të prioritetit.

Mimi Kodheli – Nuk jemi as në fazën e dytë të miratimit.

Daniela Çekani – Jo, jemi në nisje të procesit për këto alokime. Ndërkohë, për alokimet e mëparshme procesi është kryer i plotë. Pra, nuk është shpallur ende thirrja për propozime.

Mimi Kodheli – Për këto të vitit 2016?

Daniela Çekani – Ne nuk kemi dijeni.

Mimi Kodheli – A keni informacion për vitin 2015?

Daniela Çekani – ...aplikojë, sepse thirrja është e hapur.

Mimi Kodheli – Ju kuptova. Përse vini në parlament, çfarë kërkonit të miratoni?

Daniela Çekani – Arsyeja përse vijmë në parlament ka lidhje me një interpretim që Ministria e Financave ka bërë pak më përpara.

Mimi Kodheli – Patjetër, ne do t'ju japim të drejtën që të futeni me 15% në këto projekte, në mënyrë që të jeni pjesë e projektit. Ndërkohë që ne nuk dimë sa është vlera e projektit dhe miratimi që do të bëjmë sot është vetëm në parim, nuk flitet për çështje parash.

Pra, për vitin 2016 nuk është hapur thirrja fare. Për vitin 2015 a janë mbyllur procedurat?

Daniela Çekani – Po.

Mimi Kodheli – A mund të na sillni një raport që të shikojmë se çfarë ka ndodhur me 15 përqindëshin që shteti shqiptar ka alokuar në vitin 2014, kur është hapur projekti, pra të paktën për këta dy vjet? Çfarë është bërë me këto para që përmendi zoti Fino, me këtë 15 përqindësh të fondeve të hapura nga Komisioni European gjatë viteve 2014 – 2015? Ku kanë shkuar dhe si janë alokuar? Çfarë matësish dhe indikatorësh cilësore ka pasur për të parë nëse këto para janë shpenzuar ashtu siç duhet si në Kosovë, ashtu edhe në kufi, apo kemi dyshimet tona?

Daniela Çekani – Këto të dhëna ne mund t'ju vëmë në dispozicion për projektet që aktualisht janë shpallur fituese. Kuotën e bashkëfinancimit e ka për detyrim ta mundësojë institucioni qendror, pasi janë partner në projekte të ndryshme respektive.

Mimi Kodheli – Kë quani institucion qendror?

Daniela Çekani – Ministrinë. Secili nga partnerët në projekt. Për shembull, në rastin e organizatave jofitimprurëse ato e kanë detyrim.

Mimi Kodheli – Koordinator jeni ju dhe ju keni përgjegjësi.

Daniela Çekani – Ne jemi koordinator programi dhe prioritetesh. Pra, ne mbledhim prioritete nga të gjitha ministrinë e interesuara...

Mimi Kodheli – Ju i ndiqni deri në fund, sepse nuk jeni mbi palet.

Daniela Çekani – Ne nuk ndërtojmë partneritete për të funksionuar më pas implementimi i projekteve, ajo është në vullnetin e lirë të përfituesve dhe aplikuesve. Pra, ata gjejnë partnerë të tjerë...

Mimi Kodheli – Ka një arsye përse. 15% e fondeve janë nga taksapaguesit shqiptarë. Nuk ka të bëjë me vullnetin e lirë, që unë po të dua e bëj, po të dua nuk e bëj. Me vullnetin e lirë mund të abuzohet, por nuk është fjala që abuzohet nga ana juaj.

Daniela Çekani – Jo institucioni që unë përfaqësoj, por vullneti i lirë i aplikantëve.

Mimi Kodheli – Nëse unë si parlamentar vlerësoj që vullneti i lirë i aplikantëve ka bërë që fondet të dështojnë, nuk e miratoj më këtë 15% dhe e konsideroj të dështuar këtë projekt të IPA-s, pavarësisht parave që hyjnë në Shqipëri, sepse presupozohet që: a) tematika nuk është intriguese, b) kërkesat janë të paaplikueshme, pra e bëjnë të pamundur fitoren e projektit, c) *output*-i që del nga këto projekte mund të lërë për të dëshiruar.

Po them diçka për projektin “Zbutja e ndryshimeve klimatike”. Ju si koordinatorë në pozicionin që jeni, më thoni çfarë ka ndodhur me këtë projekt që është zbatuar deri më sot, paratë që janë harxhuar deri më sot, qofshin institucionale, NGO apo të tjera në vitin 2014! Pra, më thoni një projekt që është bërë për zbutjen e ndryshimeve klimatike që ka pasur impakt pozitiv?

Ky debat vjen për shkak të mungesës së informacionit që ne kemi. Nëse do të kishim të gjithë informacionin që kur ka filluar, çfarë ka ndodhur? Si kanë qenë aplikimet? Sa të sukseshme kanë qenë? Sa i suksesshëm ka qenë investimi i qeverisë shqiptare me 15% e saj, në mënyrë që ky aplikim jo vetëm të përfshijë sa më shumë zona, qofshin këto kufitare ose jo me Kosovë, por edhe të ketë një *output*, që ka një efekt të qenësishëm në fushën në të cilën paratë jepen?

Të pyeta për zbutjen e ndryshimeve klimatike, sepse mora shënim atë çfarë tha zoti Barbullushi. Më thoni një projekt, gjithmonë nëse e dini.

Daniela Çekani – Duke menduar që kjo është një procedurë të cilën kemi pasur një qasje tjetër të mëparshme, që është 2007-2013 dhe me alokime vjetore të miratuara po në të njëjtën mënyrë. Kjo është një skemë, që funksionon njëloj në të gjitha vendet e rajonit. Sigurisht, më parë miratohen alokimet vjetore dhe më pas përzgjidhen projektet. Kur unë i referohem vullnetit të lirë flas në bazë të ekspertizës...

Mimi Kodheli – Harrojeni vullnetin e lirë, sepse unë e kuptova vullnetin e lirë lidhur me zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Daniela Çekani - Janë 8 prioritetë në këtë program dhe ne koordinojmë 8 të tilla, por ne, si ministri, koordinojë vetëm programin, jo projektet, sepse projektet i ka për detyrë institucioni që i implementon të prodhojë *output*-et e dëshiruara. Për shembull, në rastin e ndryshimeve klimatike përgjegjëse është Ministria e Turizmit.

Mimi Kodheli – Zonjë, ju a merrni informacion?

Daniela Çekani – Sigurisht, nëpërmjet monitorimit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Më duhet të theksoj se ne jemi koordinatorë të programit, sepse kjo është edhe fjala e Bashkimit European, dhe institucioni që unë përfaqësoj monitoron programin. Projektet mund të jenë me qindra të tillë dhe përgjegjësinë e ka partneri dhe institucioni lider, i cili është përgjegjës për prioritetin në fjalë, si në rastin ndryshimeve klimaterike mund të jetë Ministria e Mjedisit. Sigurisht, ne marrim informacion në bazë të monitorimit që bëjmë, por jemi koordinatorë programi. Kjo ka një diferencë shumë të madhe, sepse ne nuk mund të ushtrojmë kompetenca të tilla, sepse kjo marrëveshje pikërisht këtë jep.

Gazmend Barbullushi - Për alokimet e vitit 2015 ne do të sigurojmë atë informacion që kemi dhe do t'jua vëmë në dispozicion pa asnjë problem.

Mimi Kodheli – Është absolutisht e nevojshme që ne ta kemi këtë informacion. Zonjë, fakti që ju vetëm koordinoni, nuk ju bën më pak përgjegjës, sepse jeni ju që vini dhe e mbron alokimin dhe e mbron këtë zbatimin e projektit, përndryshe presupozohet që çdo ministri duhet të vinte dhe të përgjigjej. Fakti që kjo punë ka një krye, me shumë të drejtë, do thotë se edhe ju jeni po aq përgjegjës, si përfaqësues të shtetit shqiptar. Ne këtu po flasim për shuma të konsiderueshme, nuk po flasim për gjëra të vogla, ndaj nuk ju bën më pak përgjegjës. E ritheksoj edhe njëherë se fakti që ne hyjmë në këtë debat mbase është edhe për shkak të mungesës së informacionit të plotë që ne kemi, kështu që kjo na bën të hidhemi degë më degë dhe të pyesim për të plotësuar pazëllin tonë të gjësë.

Në mënyrë absolute shteti shqiptar i mbështet projektet IPA dhe agjencitë janë vetëm përfituese të kësaj gjëje, kështu që janë më shumë se sa të mirëpritura. Fakti që ne kemi një kontribut prej 15%, sepse mund të ishte edhe 1,5% dhe përsëri të quhej kontribut, na bën neve më dorështrënguar dhe më kërkues në miratimin e këtyre fondeve, me qëllim që në fund të ditës të kuptojmë se si u shpenzuan paratë, a kanë impakt, a kanë *output*-e e kështu me radhë. Besoj se ju do të vendosni vetë një *date line*, se kur ky informacion duhet të vijë, sepse ne jemi gjithmonë të hapur.

Atëherë, e hedhin projektligjin në votë.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit

ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votim në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA